



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.46

23 prill

2007

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i GJK nr.10, datë 4.4.2007	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.1036, datë 23.6.2005 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën	1175
Vendim i GJK nr.11, datë 4.4.2007	Me objekt shfuqizimin e nenit 9 të ligjit nr.9583, datë 17.7.2006 “Për disa ndryshime e shtesa në ligjin nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, si i papajtueshëm me Kushtetutën.....	1177
Vendim i GJK nr.12, datë 13.4.2007	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.600, datë 22.7.2005 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën.....	1180
Vendim i GJK nr.13, datë 13.4.2007	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr.761, datë 9.11.2005 dhe nr.1, datë 14.4.2006 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (Dhoma e Këshillimit), si të papajtueshëm me Kushtetutën.....	1183
Vendim i GJK nr.14, datë 17.4.2007	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr.356, datë 14.4.2003 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë; nr.599, datë 15.11.2003 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.295, datë 12.5.2006 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën....	1185
Vendim i GJK nr.15, datë 18.4.2007	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr.13, datë 7.5.2003 të KRRTRSH-së; nr.5422, datë 19.12.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr.38, datë 28.6.2005 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.890, datë 30.6.2006 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën	1192

VENDIM
Nr.10, datë 4.4.2007

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Vjollca Meçaj	Anëtare e “ “

me sekretare Brunilda Bara, në datën 8.12.2006, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.46/16 Akti që i përket:

KËRKUES: SHOQËRIA TREGTARE “ALBANIAN INTERNATIONAL INVESTMENT & DEVELOPMENT CO” SHPK, përfaqësuar nga avokat Envi Hicka, me autorizim.

SUBJEKT I INTERESUAR: KËSHILLI I MINISTRAVE, përfaqësuar nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, Artan Kodheli.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr.1036, datë 23.6.2005 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Neni 42 i Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe nenet 6 e 13 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe:

- Në urdhrin nr.2, datë 3.12.2004 të Ministrit të Financave, Shoqëria Tregtare cilësohet si subjekt i lidhur me terrorizmin, ndërkohë që emri i saj nuk përmendet në listën e Kombeve të Bashkuara apo në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave, të cilat kanë përcaktuar subjektet e lidhura me veprimtarinë e terrorizmit ndërkombëtar dhe që, sipas ligjit, përbëjnë bazën ligjore për nxjerrjen e urdhrit të sipërcituar të Ministrit të Financave.

- Vendimi nr.1036, datë 23.6.2005 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë vjen në kundërshtim me nenin 42 të Kushtetutës, me nenin 13 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, që imponon ekzistencën e mjetit efektiv të ankimit në mbrojtje të të drejtave të njohura brenda strukturave shtetërore të vendeve palë, si dhe nenin 22 të ligjit nr.9258, datë 15.7.2004 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”.

- Gjykata e Lartë i ka mohuar të drejtën për t’iu drejtuar gjykatës, pa dhënë asnjë argument juridik dhe pa përcaktuar organin që ka juridiksion për shqyrtimin e ankimit ndaj urdhrit të Ministrit të Financave që i ka cenuar të drejtat pasurore.

- Gjykata e Lartë, duke interpretuar gabim ligjin, e ka konsideruar kërkuesin subjekt të lidhur me terrorizmin në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Avokati i Shtetit parashtroi këto shkaqe për rrëzimin e kërkesës:

- Kërkuesi është pronar në 45 % të kuotave të shoqërisë “Karavan”, ndërkohë që 55 % të tyre i përkasin shtetasit arab Yasin al-Qadi, person i lidhur me terrorizmin dhe financues i tij. Të qenët bashkëpronar në një shoqëri tregtare nuk është çështje mirëbesimi apo interesi indirekt, por një bashkëpunim i plotë, që në rastin konkret shtrihet dhe në financimin e terrorizmit.

- Komiteti i Këshillit të Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara përbën panelin ku mund të ankohet kërkuesi, dhe jo sistemi gjyqësor kombëtar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Vjollca Meçaj, përfaqësuesin e kërkuarit, subjektin e interesuar dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Në zbatim të ligjit nr.9258, datë 15.7.2004 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, Ministri i Financave, me urdhrin nr.2, datë 3.12.2004, ka urdhëruar, midis të tjerave, sekuestrimin e pasurive dhe të llogarive bankare të Shoqërisë Tregtare “Albanian International Investment & Development Co” sh.p.k., dega Tiranë. Kjo shoqëri tregtare, me cilësinë e paditësit, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe duke arsyetuar se, siç përcakton neni 22 i ligjit nr.9258, datë 15.7.2004 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, është person i interesuar në mirëbesim, ka kërkuar anulimin e pjesshëm të urdhrin të sipërshtuar, për pjesën që përcakton sekuestrimin e pasurive të saj. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, mbi kërkesën e palës së paditur, përfaqësuar nga Avokati i Shtetit, ia ka përcjellë çështjen Gjykatës së Lartë, për t’u shprehur në mënyrë përfundimtare lidhur me juridiksionin gjyqësor mbi këtë objekt. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.1036, datë 23.6.2005, ka vendosur nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor.

Shoqëria tregtare kërkuese ka pretenduar papajftueshmërinë me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr.1036, datë 23.6.2005 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe ka parashtruar shkaqe, të cilat i referohen shkeljes së të drejtës për t’iu drejtuar gjykatës dhe të drejtës së mbrojtjes, si aspekte të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Gjykata Kushtetuese konstatoi se kërkuesi legjitimohet t’i drejtohet kësaj Gjykate. Ai përfaqëson një person juridik shqiptar, i regjistruar rregullisht sipas ligjit me vendim gjyqësor¹ dhe çështjet që parashtron e pretendon lidhen me zhvillimin e procesit të parregullt ligjor, nëpërmjet të cilit, sipas tij, i janë cenuar të drejtat pasurore. Kërkuesi i ka shterur të gjitha mjetet juridike të mundshme për të kërkuar dëgjimin e ankimit të tij. Ai i është drejtuar sistemit gjyqësor të zakonshëm për të kundërshtuar aktin administrativ që ka urdhëruar sekuestrimin e pasurive të tij dhe nuk disponon mjet tjetër të zakonshëm juridik për të kundërshtuar vendimin e Gjykatës së Lartë që e nxjerr çështjen e tij jashtë juridiksionit gjyqësor.

E drejta për t’iu drejtuar gjykatës lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me juridiksionin dhe kompetencën e gjykatave, të cilat nga ana e tyre gjejnë rregullim në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, por edhe në ligje të tjera. Kuptimi dhe interpretimi i drejtë i këtyre dispozitave, si rregull, është detyrë e Gjykatës së Lartë, por në kuadër të gjykimit kushtetues, si metodë pune, këtë interpretim e bën dhe Gjykata Kushtetuese, gjithmonë në funksion të verifikimit të pretendimeve lidhur me procesin e rregullt ligjor.² Në rastin në shqyrtim, Gjykata Kushtetuese vlerëson nëse interpretimi i normave, bërë nga Gjykata e Lartë, i ka cenuar kërkuarit ndonjë element të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor.

Sipas nenit 42/2 të Kushtetutës, kushdo mund t’i drejtohet gjykatës për të mbrojtur një të drejtë, liri apo interes kushtetues e ligjor. Gjykata Kushtetuese vëren se kjo dispozitë, ndër të tjera, ka për qëllim të garantojë shtetasit nga çdo veprim që u shkakton cenim të të drejtave të tyre, pa përjashtuar rastet kur cenimi vjen nga ndonjë akt i administratës shtetërore. Dispozita u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t’i drejtohen një gjykate, e cila do t’i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë, publik e të paanshëm. Shteti i së drejtës presupozon që çdo ndërhyrje e autoriteteve ekzekutive në të drejtat e individit apo të personave juridikë, duhet të jetë objekt i një kontrolli efektiv nga një organ që ofron garantimin e pavarësisë dhe paansisë gjatë procesit të shqyrtimit të konfliktit.

Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, duke nxjerrë mosmarrëveshjen objekt gjykimi jashtë juridiksionit gjyqësor, bie ndesh me dispozitat kushtetuese të sipërcituara, ashtu dhe me dispozitat ligjore në fuqi, që zbatojnë parimet kushtetuese në këtë aspekt. Të tilla janë nenet 324 e 325 të Kodit të Procedurës Civile, ku përcaktohet se në kompetencë të seksioneve për gjykimet

¹ Vendimi nr.21618, datë 8.7.1999 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ????

² Vendimi nr.10, datë 11.5.2006 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

administrative është “padia me të cilën kërkohet shfuqizimi ose ndryshimi i një akti administrativ”, si dhe neni 22 i ligjit nr.9258, datë 15.7.2004 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”. Në këtë të fundit parashikohet në mënyrë të shprehur e drejta e ankimit nga çdo subjekt i interesuar apo në mirëbesim, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për të kërkuar të drejtat lidhur me pasuritë e sekuestruara me akt administrativ. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë arsyeton në vendimin e tij se kërkuesi nuk ka pretenduar të jetë person në mirëbesim, ndërkohë që nga materialet e dosjes gjyqësore rezulton se një përcaktim të tillë ai e ka parashtruar në kërkesëpadinë drejtuar gjykatës së rrethit gjyqësor, gjatë gjykimit të çështjes nga ajo gjykatë, si dhe në ankimin drejtuar Gjykatës së Lartë.

Përfundimisht, Gjykata Kushtetuese çmon se qëndrimi i mbajtur nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë prek standardet kushtetuese të procesit të rregullt ligjor, në aspektin e pengimit të shqyrtimit të çështjes nga gjykata, duke i mohuar shoqërisë kërkuese të drejtën për gjyq.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 132 të Kushtetutës, si dhe nenit 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr.1036, datë 23.6.2005 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

- Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM

Nr.11, datë 4.4.2007

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergji Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar i“ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Vjollca Meçaj	Anëtare e “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i“ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i“ “

me sekretare Brunilda Bara, në datë 6.12.2006, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.41/11 Akti, që i përket:

KËRKUES: SHOQATA E QIRAMARRËSVE TË SHTËPIVE SHTETËRORE ISH-PRONË PRIVATE, përfaqësuar nga avokate Luljeta Petani, me autorizim.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. **SHOQATA KOMBËTARE E TË SHPRONËSUARVE “PRONËSI ME DREJTËSI”**, përfaqësuar me avokat Agim Tartari, me autorizim.

2. **KUVENDI I SHQIPËRISË**, përfaqësuar nga Lulzim Lelçaj, këshilltar juridik, me autorizim.

3. **KËSHILLI I MINISTRAVE**, përfaqësuar nga Enkelejd Alibeaj, këshilltar juridik, me

autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i nenit 9 të ligjit nr.9583, datë 17.7.2006 “Për disa ndryshime e shtesa në ligjin nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”.

Pala kërkuese ka parashtruar këto shkaqe për papajtueshmërinë me Kushtetutën të dispozitës së kundërshtuar të ligjit të mësipërm:

- Neni 9 pika 1 e ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës” është shfuqizuar me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.26, datë 2.11.2005, për shkak se qiramarrësve me këtë dispozitë u cenoheshin të drejtat e fituara.

- Neni 9 i ligjit nr.9583, datë 17.7.2006 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës” vjen në kundërshtim me rekomandimet e vendimit të mësipërm të Gjykatës Kushtetuese. Ky nen është diskriminues, sepse nuk parashikon detyrimin e shtetit për të marrë përsipër strehimin e qiramarrësve, mbi të njëjtat kritere që përfitoi pjesa tjetër e popullsisë sipas ligjit nr.7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Petrit Plloçi, përfaqësuesen e palës kërkuese, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Me ligjin nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës” dhe konkretisht në nenin 9, është rregulluar trajtimi i qiramarrësve të shtëpive shtetërore ish-pronë private që do t’u ktheheshin ish-pronarëve. Kjo dispozitë në pikën 1 parashikon:

“Banesat, pronë e subjekteve të shpronësuara, lirohen nga qiramarrësit brenda një afati 3-vjeçar. Qiramarrësit vazhdojnë të paguajnë qira të përcaktuar nga Këshilli i Ministrave deri në dy vjet pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Këshilli i Ministrave ngarkohet të sigurojë strehimin qiramarrësve, që kanë statusin e të pastrehëve, nëpërmjet banesave me qira të ulët, kredive me interes të ulët ose banesave me qira të kompensuar nga shteti.”.

Mbi kërkesën e Shoqatës së Qiramarrësve të Shtëpive Shtetërore ish-Pronë Private, Gjykata Kushtetuese me vendimin nr.26, datë 2.11.2005 ka vendosur shfuqizimin si antikushtetues të dispozitës së sipërcituar, duke arsyetuar, në esencë, se kjo dispozitë shkel parimin e sigurisë juridike (nëpërmjet cenimit të të drejtave të fituara), si dhe diskriminon një grup të popullsisë, siç janë qiramarrësit e shtëpive shtetërore ish-pronë private.

Kërkuesi ka kundërshtuar përsëri si jokushtetues edhe nenin 9 të ligjit nr.9583, datë 17.7.2006 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të miratuar pas shfuqizimit nga Gjykata Kushtetuese të dispozitës së mëparshme. Neni 9 pika 1 i ligjit në fuqi parashikon: *“Banesat, pronë e subjekteve të shpronësuara, të cilat u janë dhënë me qira qiramarrësve nga shteti para hyrjes në fuqi të ligjit nr.7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore” dhe që shfrytëzohen për nevoja strehimi, kalojnë në posedim të subjekteve të shpronësuara, kur vërtetohet një nga rastet e mëposhtme:*

a) qiramarrësit kanë plotësuar nevojat e tyre për strehim në çfarëdo mënyrë tjetër të ligjshme;
b) subjektet e shpronësuara u ofrojnë qiramarrësve strehim në sipërfaqe jo më të vogël dhe me kushte të përafërta me strehimin që kanë në përdorim, brenda së njëjtës njësi të qeverisjes vendore, derisa qiramarrësit të plotësojnë nevojat e tyre për strehim në njërën nga mënyrat e tjera të parashikuara në këtë nen;

c) qiramarrësit nënshkruajnë kontratën e kredisë me institucionin financiar, sipas pikave 1 dhe 2 të nenit 25 të ligjit nr.9232, datë 13.5.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”;

ç) qiramarrësit përfitojnë strehim ose truall, sipas pikës 3 të nenit 25 të ligjit nr.9232, datë 13.5.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”.

Në këto kushte, Gjykata Kushtetuese verifikoi nëse neni 9 i kundërshtuar është në harmoni me vendimin e mësipërm, pra nëse prek përsëri të drejtat e fituara të qiramarrësve të banesave ish-pronë private dhe nëse shkakton diskriminim.

Sipas vendimit nr.26, datë 2.11.2005 të cituar më sipër, deri me hyrjen në fuqi të nenit 9 të

ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, qiramarrësit e shtëpive shtetërore ish-pronë private kishin një sërë të drejtash, të tilla si e drejta e qirasë sipas tarifave të vitit 1993 deri në zgjidhjen e strehimit (neni 4 i ligjit nr.8647, datë 24.7.2000), sigurimi i banesës nga shteti, nëpërmjet Entit Kombëtar të Banesave, sipas kritereve të ligjit nr.7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore” (neni 1 i ligjit). Neni 9 i ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës” nuk parashikon më detyrimin e shtetit t’u siguronte banesë këtyre qiramarrësve nëpërmjet privatizimit të banesave sipas kritereve të ligjit sipërcituar të vitit 1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore”. Kjo dispozitë parashikon strehimin e qiramarrësve *nëpërmjet banesave me qira të ulët, kredive me interesa të ulëta ose banesave me qira të kompensuar nga shteti*. Përveç kësaj, ndërsa rregullimi i 2004 ruan *ngrirjen e qirasë* vetëm për dy vjet, *detyrimin për lirin e banesës* nuk e lidh me strehimin përfundimtar të qiramarrësit.

Gjykata Kushtetuese konstaton se edhe rregullimi ligjor i bërë nëpërmjet nenit 9 të ligjit objekt shqyrtimi, në esencë, ofron po ato alternativa që ofronte neni 9 i shfuqizuar, të cilat, me vendimin e sipërpërmendur, janë konsideruar jokushtetuese, sepse cenojnë parimin e sigurisë juridike, si dhe shkaktojnë diskriminim të një grupi. Kështu, si alternativa të strehimit të qiramarrësve të kësaj kategorie parashikohen *plotësimi vetë i nevojave të strehimit, sigurimi i strehimit nga ana e subjekteve të shpronësuar, strehimi nëpërmjet kredisë, sipas pikave 1 dhe 2 të ligjit nr.9232, datë 13.5.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, si dhe strehimi ose marrja e truallit, në bazë të pikës 3 të ligjit të sipërcituar*. Ky rregullim ligjor cenon të drejtën e kësaj kategorie qiramarrësish dhe përse i përket *ngrirjes së qirasë*, ndërsa *detyrimin për lirin e banesës* nuk e lidh me strehimin përfundimtar të qiramarrësve.

Gjykata Kushtetuese konstaton, gjithashtu, se një pjesë e qiramarrësve të banesave ish- -pronë private kanë përfituar banesë në kushtet e nenit 1 të ligjit nr.8647, datë 24.7.2000 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8030, datë 15.11.1995 “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha”. Për pasojë, një trajtim më i pafavorshëm i pjesës tjetër të qiramarrësve, të cilët janë në të njëjtat kushte me të parët, përbën një diskriminim jokushtetues.

Në këto kushte, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se neni 9 i ligjit në shqyrtim, është në kundërshtim me parimin e shtetit të së drejtës dhe barazisë para ligjit, dhe si i tillë duhet të shfuqizohet si i papajtueshëm me Kushtetutën.

Meqenëse me shfuqizimin e dispozitës në shqyrtim krijohet boshllëk ligjor lidhur me trajtimin e qiramarrësve të shtëpive ish-pronë private, në bazë të nenit 78 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i rekomandohet Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit të Shqipërisë të marrë masa për të bërë plotësimet e nevojshme në ligj.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 51, 72 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të nenit 9 të ligjit nr.9583, datë 17.7.2006 “Për disa ndryshime e shtesa në ligjin nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM
Nr.12, datë 13.4.2007

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergji Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar i“ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Vjollca Meçaj	Anëtare e “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i“ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i“ “

me sekretare Brunilda Bara, në datë 16.3.2007, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.29 Akti, që i përket:

KËRKUES: BLERIM ELEZI, LUAN CURRI, përfaqësuar nga avokatët Agim Hoxha e Neshat Fana, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR: PROKURORIA E PËRGJITHSHME, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr.600, datë 22.7.2005 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f e 134/g të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, si dhe neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Kërkuesit kanë parashtruar si shkak për shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit të mësipërm, pjesëmarrjen në përbërje të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (kolegjit seleksionues) të një gjyqtari, i cili për të njëjtën çështje kishte marrë pjesë edhe në trupin gjykues të Gjykatës së Apelit Durrës. Sipas tyre, kjo pjesëmarrje cenon parimin e paanshmërisë në gjykim, i cili është element i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor, garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Xhezair Zaganjori, përfaqësuesit e kërkuesve dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Me vendimin nr.2, datë 5.1.2004 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, kërkuesi Blerim Elezi është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale të marrëdhënies seksuale me dhunë me të mitura e mbetur në tentativë, dhe në bazë të neneve 101/1 e 22 të Kodit Penal është dënuar me 8 vjet burgim. Me të njëjtin vendim, është deklaruar fajtor edhe kërkuesi Luan Curri për kryerjen e veprës penale të marrëdhënies seksuale me dhunë me të mitura në bashkëpunim dhe për veprën penale të marrëdhënies seksuale me dhunë me të mitura e mbetur në tentativë, dhe në bazë të neneve 101/2, 25, 101/1, 22 dhe 55 të Kodit Penal është dënuar me 10 vjet burgim.

Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr.346, datë 17.11.2004, ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, dhoma e këshillimit, me vendimin nr.600, datë 22.7.2005, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga të gjykuarit.

Kërkuesit, bazuar në nenet 131/f e 134/g të Kushtetutës, kanë pretenduar në Gjykatën Kushtetuese se ndaj tyre, në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë, është zhvilluar një proces jo i rregullt ligjor, në vështrim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Sipas tyre, në shqyrtimin e çështjes në këtë kolegji ka marrë pjesë edhe një gjyqtar, i cili ka qenë dhe në përbërjen e trupit gjykues që ka gjykuar kërkuesit po për këtë çështje në Gjykatën e Apelit

Durrës. Ata theksuan se kjo pjesëmarrje ka cenuar parimin e rëndësishëm të paanshmërisë në gjykim, i cili, në kuptimin kushtetues është një nga elementet e rëndësishme të procesit të rregullt ligjor.

Gjykata Kushtetuese vlerëson se pretendimet e kërkuësve janë të drejta dhe kërkesa e tyre duhet pranuar.

Një nga elementet e rëndësishme të procesit të rregullt ligjor apo të procesit të drejtë të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, është edhe ai i paanshmërisë së gjykatës në gjykimin e çështjes.

Në këtë kuadër, Gjykata Kushtetuese thekson se parimi i paanshmërisë ka në vetvete elementin e vet subjektiv, i cili lidhet ngushtë me bindjen e brendshme që krijon gjyqtari për zgjidhjen e çështjes në gjykim, si dhe elementin objektiv me të cilin kuptohet dhënia e garancive të nevojshme për gjykim të paanshëm nga vetë gjykata, përmes mënjanimit prej saj të çdo dyshimi të përligjur në këtë drejtim. Ndër të tjera, gjykata duhet të jetë e kujdesshme dhe të marrë parasysh veçanërisht problemin e përbërjes së trupit gjykues, në mënyrë që të mënjanohen nga gjykimi i çështjes gjyqtarët që nuk kanë garancitë e kërkuara për paanshmëri në kuptimin objektiv. Në shtetin e së drejtës, kjo kërkesë merr rëndësi të veçantë në funksion të besimit në dhënien e drejtësisë që duhet të krijojnë në çdo rast në shoqërinë demokratike jo vetëm palët në gjykim, por çdo qytetar i thjeshtë.¹

Për këtë qëllim dhe në funksion të këtij parimi të rëndësishëm kushtetues deklarohen edhe dispozita të veçanta ligjore. Kështu, në nenin 15 të Kodit të Procedurës Penale theksohet shprehimisht se “Gjyqtari që ka dhënë ose ka marrë pjesë në dhënien e vendimit në një shkallë të procedimit nuk mund të ushtrojë funksionet e gjyqtarit në shkallët e tjera, as të marrë pjesë në rigjykim pas prishjes së vendimit”.

Nga sa më sipër, është mëse e qartë që parimi i paanshmërisë në gjykim edhe në këndvështrim të përbërjes së trupit gjykues, duhet të respektohet në çdo shkallë të gjykimit, pra edhe në shqyrtimin e çështjes në Gjykatën e Lartë. Kjo do të thotë që gjyqtari i Gjykatës së Lartë nuk mund të jetë anëtar i një kolegji, nëse për të njëjtën çështje ka marrë pjesë në dhënien e një vendimi në një shkallë të mëparshme të procedimit.

Në fakt, shqyrtimi i çështjes nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, nuk i ka të gjitha karakteristikat e një gjykimi në kuptim të nenit 15 të Kodit të Procedurës Penale. Në këtë rast nuk kemi një seancë publike. Nuk ka shpallje të datës apo të përbërjes së dhomës së këshillimit dhe çështja shqyrtohet pa praninë e prokurorit, të pandehurit apo mbrojtësit të tij. Në dhomën e këshillimit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vlerëson pretendimet e ngritura në rekursin e paraqitur kundër një vendimi të formës së prerë. Nëse ka shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 432 i Kodit të Procedurës Penale vendoset kalimi i çështjes në seancë gjyqësore. Në të kundërt, vendoset mospranimi i rekursit. Ky vlerësim bëhet gjithnjë në funksion të kompetencës që ka Gjykata e Lartë për të kontrolluar mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga gjykatat më të ulëta, pra nga gjykata e rrethit gjyqësor dhe gjykata e apelit.²

Por, një vlerësim i tillë mjaft i rëndësishëm për fatin e çështjes duhet bërë nga një gjykatë e paanshme. Është e papranueshme që një gjyqtar, që ka marrë pjesë në dhënien e një vendimi në një shkallë të mëparshme të gjykimit (në rastin konkret në gjykatën e apelit), të jetë sërish në përbërje të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, që do të shqyrtojë e vlerësojë shkaqet e rekursit që janë pikërisht edhe kundër këtij vendimi.

Në rastin konkret, dyshimi i kërkuësve për njëanshmëri në shqyrtimin e çështjes në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë të mbledhur në dhomën e këshillimit është i drejtë.³ Një nga gjyqtarët në përbërje të këtij kolegji ka marrë pjesë më parë në trupin gjykues në Gjykatën e Apelit Durrës, i cili ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, që ka gjetur fajtorë dhe dënuar kërkuësit respektivisht me 8 vjet dhe 10 vjet burgim. Madje, në këtë rast, ky gjyqtar kishte qenë edhe relator i çështjes.

Mbi këtë bazë duhej të ishte mënjeluar pjesëmarrja e këtij gjyqtari në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë të mbledhur për shqyrtimin e rekursit të kërkuësve. Vetë të gjykuarit apo mbrojtësit e tyre nuk e kanë pasur dhe as nuk mund ta kenë mundësinë ta kërkojnë këtë në këtë fazë të shqyrtimit

¹ Shih vendimin nr.16, viti 2003 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

² Shih vendimin nr.25, viti 2003 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

³ Shih vendimin çështja Oberschick 1 kundër Austrisë, date 23.05.1991 të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

të çështjes në Gjykatën e Lartë, pasi ata nuk janë të pranishëm.

Gjykata Kushtetuese rithekson se shqyrtimi i çështjes nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, është pjesë e rëndësishme e procesit gjyqësor në tërësi dhe si i tillë, në përputhje me natyrën e këtij shqyrtimi në dhomën e këshillimit, duhet të respektojë parimet themelore të procesit të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues. Këtu, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet veçanërisht problemeve që kanë të bëjnë me përbërjen e kolegjit, pasi siç u theksua, kjo lidhet ngushtë me çështjen e paanshmërisë së gjykatës në shqyrtimin e çështjes.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131/f e 132 të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr.600, datë 22.7.2005 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM

Nr.13, datë 13.4.2007

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergji Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese,
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Vjollca Meçaj	Anëtare e “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “

me sekretare Brunilda Bara, në datë 20.2.2007, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.27 Akti, që i përket:

KËRKUES: SALI DEDEJ, përfaqësuar nga avokat Islam Llapi, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR: PROKURORIA E PËRGJITHSHME, përfaqësuar nga Valentin Preçi, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimin si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimeve nr.761, datë 9.11.2005 dhe nr.1, datë 14.4.2006 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (dhoma e këshillimit).

BAZA LIGJORE: Neni 131/f i Kushtetutës dhe neni 31 i ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë".

Kërkuesi ka pretenduar se vendimet e kundërshtuara janë rezultat i një procesi jo të rregullt ligjor në drejtimit e mëposhtme:

- Për vendimin nr.761, datë 9.11.2005 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, shkelja qëndron në mosnjohimin e rekursit të prokurorit të apelit, si dhe në mosnjohimin e datës së gjykimit.

- Për vendimin nr.1, datë 14.4.2006, të marrë në dhomën e këshillimit të Kolegjit Penal të

Gjykatës së Lartë, shkelja qëndron në mosnjohimin e kërkesës për rishikim, në gjykimin e çështjes në mungesë të kërkuarit dhe të avokatit të tij, si dhe në prishjen e vendimit në dhomën e këshillimit, pa e shqyrtuar atë në seancë gjyqësore në prani të palëve.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Petrit Plloçi, përfaqësuesin e kërkuarit, përfaqësuesin e subjektit të interesuar dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Mbi bazën e këtij kallëzimi, organi i prokurorisë ka nisur procedimin penal nr.1232. Më pas, me vendimin datë 20.12.2003 prokuroria ka pushuar hetimet për këtë procedim.

Mbi ankimin e Shemsi Picarit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.397, datë 29.4.2004, ka vendosur: Prishjen e vendimit datë 20.12.2003 të prokurorisë, duke urdhëruar vazhdimin e hetimeve.

Mbi ankimin e kërkuarit Sali Dedej, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.771, datë 12.11.2004, ka vendosur: Prishjen e vendimit nr.397, datë 29.4.2004 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke lënë në fuqi vendimin e prokurorisë datë 20.12.2003 për pushimin e hetimeve.

Pa u gjykuar ankimi i mësipërm i kërkuarit Sali Dedej në Gjykatën e Apelit Tiranë, mbi kërkesën e Prokurorisë Tiranë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.737, datë 2.7.2004, ka vendosur: Deklarimin fajtor të të pandehurit, kërkuarit Sali Dedej për veprën penale të falsifikimit, parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal dhe e ka dënuar me gjobë në shumën 200 mijë lekë.

Mbi ankimin e të gjykuarit, kërkuarit Sali Dedej, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.35, datë 25.1.2005, ka vendosur: Prishjen e vendimit nr.737, datë 2.7.2004 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe pushimin e çështjes.

Mbi rekursin e prokurorisë së apelit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.761, datë 9.11.2005, ka vendosur: Prishjen e vendimit nr.771, datë 12.11.2004 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe lënien në fuqi të vendimit nr.397, datë 29.4.2004 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Mbi kërkesën për rishikim të prokurorit të apelit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr.1, datë 14.04.2006, ka vendosur: Prishjen e vendimit nr.35, datë 25.1.2005 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në atë gjykatë, me trup gjykues tjetër.

Dy vendimet e fundit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë janë kundërshtuar nga kërkuari në Gjykatën Kushtetuese.

Me këtë rast, Gjykata Kushtetuese riafirmojnë qëndrimin e saj, se pjesëmarrja e palëve dhe respektimi i parimit të barazisë së armëve dhe i parimit të kontradiktoritetit janë elemente të rëndësishme të një procesi të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Në këtë vështrim, gjykata që ka çështjen për shqyrtim detyrohet të marrë të gjitha masat e nevojshme për pjesëmarrjen e palëve apo të përfaqësuesve të tyre në proces, gjë që u krijon atyre mundësinë që të shprehin pikëpamjet e tyre lidhur me aspektet faktike dhe ligjore të çështjes në gjykim.

Gjykata Kushtetuese konstaton se në çështjen në shqyrtim janë cenuar standardet e një gjykimi të drejtë në aspektin kushtetues.

Nga dosja e administruar dhe nga shpjegimet e palëve në seancë plenare rezultoi se në datë 9.11.2005 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka marrë në shqyrtim rekursin e prokurorit të apelit, me objekt prishjen e vendimit nr.771, datë 12.11.2004 të Gjykatës së Apelit Tiranë. Gjykimi nga ana e kolegjit penal është zhvilluar në mungesë të të gjykuarit dhe të avokatit të tij mbrojtës. Rezultoi gjithashtu se kërkuarit nuk i është dorëzuar një kopje e rekursit të prokurorit të apelit. Për pasojë, Gjykata Kushtetuese vlerëson se në mungesë të marrjes nga ana e kërkuarit të kopjes së rekursit të prokurorit, njoftimi i tij për gjykimin në Gjykatën e Lartë është i pamjaftueshëm në aspektin procedural. Kjo për faktin se, ashtu siç ka pranuar Gjykata Kushtetuese, edhe në raste të tjera të kësaj natyre, njoftimi i pjesëmarrësit në proces, të cilit i kundërshtohet rekursi, është një proces dy fazësh, ku fillimisht këtij i dorëzohet një kopje e rekursit të paraqitur nga pala tjetër, dhe vetëm pas konfirmimit të marrjes së rekursit, vendoset shpallja për datën e gjykimit të rekursit. Ndërsa detyrimi për të ndjekur

shpalljen e Gjykatës së Lartë për ditën e gjykimit, pjesëmarrësit në proces i bie vetëm pas marrjes së kopjes së rekursit. Në këto kushte, shqyrtimi i çështjes në mungesë, në kushtet kur kërkuesi nuk ka marrë njoftim, e bën të parregullt procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë.

Rezultoi gjithashtu se në datë 14.4.2006 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, pa praninë e palëve, ka marrë në shqyrtim kërkesën e prokurorit të apelit, me objekt rishikimin e vendimit nr.35, datë 25.1.2005 të Gjykatës së Apelit Tiranë. Në përfundim të shqyrtimit, kolegji penal ka vendosur prishjen e vendimit të sipërpërmendur të gjykatës së apelit dhe e ka kthyer çështjen për rigjykim po në këtë gjykatë.

Gjykata Kushtetuese vlerëson se edhe ky gjykim i zhvilluar nga ana e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, është në kundërshtim me parimet bazë për një proces të rregullt ligjor.

Nga koncepti i “procesit të rregullt ligjor” rrjedh parimi i përgjithshëm, që secila palë ka të drejtë të jetë e pranishme në seancë gjyqësore ose të përfaqësohet nga avokati i saj. Është e vërtetë se sipas Kodit të Procedurës Penale, edhe kërkesa për rishikimin e një vendimi civil të formës së prerë, i nënshtrohet seleksionimit në dhomën e këshillimit të kolegjeve përkatëse të Gjykatës së Lartë, ku verifikohet nëse plotësohen kriteret ligjore për gjykimin në seancë. Por, nëse këto kritere plotësohen, gjykata e zakonshme nuk mund të vendosë drejtpërdrejt në dhomën e këshillimit prishjen e vendimit të formës së prerë. Shqyrtimi i themelit të shkaqeve të rishikimit të vendimit realizohet në seancën gjyqësore, kur aplikohen parimet kushtetuese të dëgjimit të palëve, të barazisë së mjeteve, etj.

Parë në këndvështrimin e konsideratave të mësipërme, Gjykata Kushtetuese konstaton se gjykimi i zhvilluar në dhomën e këshillimit nuk i përmbush standardet kushtetuese të një gjykimi të drejtë.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 72 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimeve nr.771, datë 9.11.2005 dhe nr.1, datë 14.4.2006 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM

Nr.14, datë 17.4.2007

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Vjollca Meçaj	Anëtare e “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “

me sekretare Brunilda Bara, në datë 11.12.2006, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me

dyer të hapura çështjen nr.48/18 Akti që i përket:

KËRKUES: SOKOL KOÇIU, FREDERIK DURDA, ARBEN BËRBALLA, DIN GJONAJ, përfaqësuar nga avokat Shefqet Muçi, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR: PROKURORI I PËRGJITHSHËM, përfaqësuar nga Skënder Breca, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimeve nr.356, datë 14.4.2003 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë; nr.599, datë 15.11.2003 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.295, datë 12.5.2006 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Kërkuesi *Sokol Koçi* pretendon se gjykatat i kanë cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor, duke argumentuar në këto drejtime kryesore:

- Gjykatat e kanë prezumuar fajtor për një vepër, që, sipas ligjit të kohës kur është kryer, nuk përbënte vepër penale. Kërkuesi është deklaruar fajtor për trafikimin e paligjshëm të një sasive kokaine, ndërkohë që dispozita ligjore konkrete (neni 283/a) në kohën e kryerjes së veprës nuk parashikohej nga Kodi Penal.

- Ndreqja e gabimit material nga neni 284/a-1 në nenin 284/a-2 që ka bërë Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë është antikushtetuese, sepse sipas nenit 445 të Kodit të Procedurës Penale gabimet materiale mund të ndreqen vetëm nëse ato nuk kanë pasur ndikim vendimtar në dispozitivin e vendimit.

- Gjykata e Lartë e ka prezumuar fajtor kërkuesin për nenin 284/a-2, në një kohë kur nuk ka provuar ekzistencën e një organizate të vetme kriminale, që sipas nenit 28 të Kodit Penal kërkon kuorumin e nevojshëm prej tre personash.

- Gjykatat e kanë dënuar kërkuesin mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme, që lidhen me pamundësinë e pyetjes së disa dëshmitarëve kryesorë të akuzës, me ushtrimin e pushtetit gjyqësor nga një gjykatë e huaj dhe me ekzistencën e kushteve të papajtueshmërisë me detyrën e dëshmitarit.

- Kërkuesi është gjykuar nga një gjykatë e caktuar me vendim antikushtetues të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Caktimi i një gjykate të posaçme për të gjykuar çështjen e tij (ndërkohë që rezultojnë gjyqtarë të pakonsumuar me këtë çështje në Gjykatën e Apelit Tiranë) rezulton antikushtetuese, si dhe jashtë juridiksionit e kompetencave të sanksionuara nga neni 147/4 i Kushtetutës.

Kërkuesi *Din Gjonaj* ka parashtruar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në drejtim të shkeljes së parimit kushtetues se *ligji penal favorizues ka fuqi prapavepruese (neni 29/3 i Kushtetutës dhe neni 3/3 i Kodit Penal)*.

- Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka zbatuar dispozitën me masën më të rëndë të dënimit, duke e dënuar me 9 vjet burgim, ndërkohë që ligji nr.9275, datë 16.9.2004, që vepronte në kohën e gjykimin të çështjes, e ka ndryshuar nenin 333, duke parashikuar në paragrafin e dytë një dënim më të ulët, nga 4 deri në 8 vjet.

Kërkuesit *Frederik Durda* e *Arben Bërballa* cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor e argumentojnë në këto drejtime kryesore:

- Janë dënuar për një vepër penale që nuk konsiderohej e tillë në kohën e kryerjes. Gjykatat kanë gabuar, sepse nuk kanë marrë në konsideratë as kuptimin e krimit të trafikut të narkotikëve në kohën e kryerjes (neni 283/a) dhe as lidhjen që ekziston midis tij dhe nenit 284/a, të shtuara me ligjin nr.8279, datë 15.1.1998.

- Ndryshimet në Kodin Penal të vitit 2004, e lidhin krijimin dhe ekzistencën e organizatës kriminale me praninë e tre ose më shumë personave. Kolegji Penal ka fajësuar vetëm dy vetë, sepse Sokol Koçi është dënuar në bazë të paragrafit të dytë të nenit 284/a të Kodit Penal, për një figurë tjetër krimi;

- Janë mbledhur, marrë dhe përdorur prova në shkelje të ndalimeve ligjore (neni 35/4 i Kushtetutës dhe neni 151/4 i Kodit të Procedurës Penale). Këto shkelje konsistojnë në fillimin e parregullt të procesit penal dhe në pranimin e dëshmimeve të ndaluara, në marrjen si provë të dëshmimeve të Lidia Çestarit dhe një intervistë të Triana Mateus, të cilët kanë qenë të akuzuar për të njëjtën vepër apo në cilësinë e personave ndaj të cilëve zhvillohen hetime, në përdorimin si provë të përgjimeve të ndaluara nga ligji.

GJYKATA KUSHTETUESE,

dëgjo relatorin e çështjes Sokol Sadushi, përfaqësuesin e kërkuësve, të subjektit të interesuar dhe pasi e shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr.356, datë 14.04.2003, ka deklaruar fajtor kërkuësin Sokol Koçiu për veprat penale të organizimit dhe drejtimit të organizatave kriminale, me qëllim trafikimin e narkotikëve, parashikuar nga neni 284/a/2 i Kodit Penal, krijimit të bandës së armatosur dhe organizatës kriminale, parashikuar nga neni 333 i Kodit Penal, si dhe falsifikimit të letërnjoftimeve apo vizave, parashikuar nga neni 189/1 i Kodit Penal, dhe në bazë të nenit 55 të Kodit Penal i ka caktuar një dënim përfundimtar prej 15 vjet burgim.

Kërkuësit Frederik Durda dhe Arben Bërballa, krahas disa veprave të tjera, janë deklaruar fajtorë për veprat penale të organizimit dhe drejtimit të organizatave kriminale, me qëllim trafikimin e paligjshëm të narkotikëve, parashikuar nga neni 284/a/1 të Kodit Penal, si dhe të krijimit të bandës së armatosur dhe organizatës kriminale, parashikuar nga neni 333 i Kodit Penal, dhe në bazë të nenit 55 të Kodit Penal janë dënuar respektivisht me 16 dhe 15 vjet burgim.

Kërkuësi Din Gjonaj është deklaruar fajtor për veprën penale të krijimit të bandës së armatosur dhe organizatës kriminale, parashikuar nga neni 333 i Kodit Penal dhe është dënuar me 9 vjet burgim.

Mbi apelimin e kërkuësve, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.599, datë 15.11.2003, ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.295, datë 12.5.2006, ka vendosur, në pikat 1, 2 dhe 3, prishjen e vendimit nr.599, datë 15.11.2003 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe pushimin e gjykimit për veprën penale të krijimit të bandës së armatosur dhe organizatës kriminale, parashikuar nga neni 333 i Kodit Penal, për kërkuësit Sokol Koçiu, Frederik Durda dhe Arben Bërballa dhe në pikën 4 lënie në fuqi të vendimit për pjesët e tjera.

Pretendimet e kërkuësve të parashtruara para Gjykatës Kushtetuese, në përgjithësi kanë të bëjnë me parime të rëndësishme kushtetuese, që kanë ndikimin e tyre në kushtetutshmërinë e të gjithë procesit gjyqësor. Një pjesë e këtyre pretendimeve janë ngritur nga kërkuësit edhe më parë në Gjykatën Kushtetuese, të cilave nuk u është dhënë një përgjigje përfundimtare, për arsye se me vendimin nr.41, datë 29.12.2005, me të cilin është shfuqizuar si antikushtetues vendimi i dhomës së këshillimit, është mbajtur qëndrimi se *“Gjykata e Lartë duhet të investojë në ekzaminimin e tyre dhe të mbante një qëndrim të shprehur lidhur me to, sepse kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, e aq më tepër i Gjykatës së Lartë.”*¹ Mbi bazën e këtij orientimi kushtetues, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë e ka shqyrtuar çështjen në seancë gjyqësore dhe u ka dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të ngritura.

Kërkuësit, nëpërmjet dy kërkesave që në përmbajtjen e tyre ngrenë pretendime të njëjta për cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, i drejtohen përsëri Gjykatës Kushtetuese dhe kërkojnë papajtueshmërinë me Kushtetutën si të vendimeve të gjykatës së shkallës së parë e të gjykatës së apelit, ashtu dhe të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Pretendimet e tyre janë të shumta, dhe në to përfshihen si çështje të gjykimit në thelb, ashtu dhe të natyrës kushtetuese. Pretendimet e kërkuësve, të cilat janë përqendruar te zgjidhja në thelb e çështjes dhe mënyra e interpretimit të së drejtës materiale penale (mënyra e kualifikimit të veprës penale, kuptimi juridik i organizatës kriminale etj.), nuk janë ngritur në nivelin e një gjykimi kushtetues dhe për rrjedhojë, Gjykata Kushtetuese çmon se nuk mund të investohet për shqyrtimin e tyre.

Në mënyrë të përmbledhur, duke iu referuar disa parimeve kushtetuese, kërkuësit pretendojnë se janë dënuar pa ligj (parimi *nullum crimen nulla poena sine lege* - neni 29/1 i Kushtetutës), nuk u është dhënë fuqi prapavepruese ligjit penal favorizues (neni 29/3 i Kushtetutës), janë dënuar nga një gjykatë e caktuar në mënyrë antikushtetuese (neni 42 i Kushtetutës) dhe janë deklaruar fajtorë mbi

¹ Vendimi nr.41, datë 29.12.2005 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme (neni 32/2).

Duke i analizuar pretendimet e kërkuësve, rezulton se nga pikëpamja formale, ato nuk listohen në mënyrë të shprehur në nenin 42 të Kushtetutës, por parashikohen si të drejta më vete në dispozita të tjera të saj. Konkretisht, parimi i mosdënimit pa ligj, e drejta e mosdënimit mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme, e drejta e përfitimit nga efekti prapaveprues i ligjit penal favorizues, janë sanksionuar respektivisht në nenet 29/1, 3 dhe 32/2 të Kushtetutës. Këto janë parime themelore për një proces të drejtë penal dhe si të tilla, janë të rëndësishme për respektimin e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor. Për pasojë, Gjykata Kushtetuese çmon të nevojshme të shqyrtojë të gjitha këto pretendime, për arsye se ato kanë të bëjnë me thelbin e një procesi të drejtë penal.

1. Pretendimi për shkeljen e parimit të mosdënimit pa ligj (*nullum crimen nulla poena sine lege*).

Kërkuësit pretendojnë se gjykatat i kanë deklaruar fajtorë për organizimin e trafikut të narkotikëve, ndërkohë që kjo vepër penale, në kohën e kryerjes së saj, nuk parashikohej në Kodin Penal, duke shkelur në këtë mënyrë ndalimin kushtetues *nullum crimen nulla poena sine lege*, të sanksionuar në nenin 29 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 7 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Siç është shprehur në disa vendime të saj Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, garancia e mishëruar në nenin 7 të Konventës, është një element thelbësor i shtetit të së drejtës. Kjo garanci duhet të interpretohet dhe zbatohet në atë mënyrë që të ofrojë garanci efektive kundër ndjekjes, deklarimit fajtor dhe dënimit arbitrar.

Në çështjen në shqyrtim, kërkuësit: Sokol Koçi, Frederik Durda dhe Arben Bërballa, krahas disa veprave të tjera, janë deklaruar fajtorë edhe për veprën penale të “Organizimit dhe drejtimit të organizatës kriminale me qëllim trafikimin e paligjshëm të narkotikëve”, parashikuar në nenin 284/a të Kodit Penal. Sipas vendimeve të gjykatave, aktiviteti kriminal i kërkuësve është zhvilluar gjatë periudhës 1998 - janar 2001. Vepra penale për të cilën janë deklaruar fajtorë dhe dënuar kërkuësit është shtuar në Kodin Penal me ligjin nr.8279, datë 15.1.1998 “Për disa ndryshime e shtesa në ligjin nr.7895, datë 27.1.1995 “Për Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë”.

Në kuadrin e pretendimit të tyre për shkeljen e parimit të mosdënimit pa ligj, kërkuësit kanë arsyetuar se vepra penale e “Trafikut të narkotikëve”, e cila përfshin edhe trafikun ndërkombëtar të narkotikëve, është shtuar në nenin 183/a të Kodit Penal me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”.

Është e vërtetë se në vitin 2001 në Kodin Penal është shtuar neni 283/a, por siç rezulton nga materialet e dosjes, kërkuësit nuk janë deklaruar fajtorë në bazë të kësaj dispozite, por në bazë të nenit 284/a të Kodit Penal, dispozitë kjo që është miratuar në janar 1998. Siç pranohet edhe në doktrinën e së drejtës penale, në këndvështrimin e pasojave kriminale, në varësi të qenies ose jo të pasojës si element i figurës së veprës penale, këto të fundit ndahen në materiale dhe formale. Duke e analizuar në këtë vështrim figurën e veprës penale që parashikon neni 284/a, mund të konkludohet se ajo përfshihet në figurat formale të veprave penale, gjë që do të thotë se kjo vepër konsiderohet e kryer që nga momenti i organizimit dhe i pjesëmarrjes në organizatën kriminale, pavarësisht nga ardhja e pasojave. Kur nga veprimtaria e organizatës kriminale kanë ardhur edhe pasoja, atëherë veprat penale do të konkurrojnë.

Në këto rrethana, Gjykata Kushtetuese, pa marrë përsipër të vlerësojë cilësimin juridik të veprës, konkludon se vepra penale për të cilën janë deklaruar fajtorë kërkuësit parashikohej me ligj në kohën e kryerjes, dhe për pasojë, pretendimi për shkeljen e ndalimit *nullum crimen nulla poena sine lege* duhet rrëzuar.

2. Pretendimi për mosdhënien e fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues

Sipas nenit 29/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligji penal favorizues ka fuqi prapavepruese (*lex retro agit in mitius* ose *lex mitior retro agit*). Ky parim i rëndësishëm kushtetues përmendet shprehimisht edhe në nenin 15/1 të Konventës Ndërkombëtare të OKB-së mbi të Drejtat Politike e Civile, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë në datë 4.1.1992.

Parimi i përgjithshëm që vepron në sistemin e së drejtës është ai i ndalimit të fuqisë prapavepruese të ligjit. Përfundimisht që bëhet nga rregulli i përgjithshëm, duke i dhënë fuqi prapavepruese vetëm ligjit penal që favorizon pozitën e të pandehurit, synon t'i përgjigjet në mënyrë sa më të shpejtë e të përshtatshme vlerësimeve të ligjvënësist mbi rrezikshmërinë shoqërore të veprimeve apo mosveprimeve të caktuara, si dhe të subjekteve që i kanë kryer apo mund t'i kryejnë ato në të ardhmen.

Duke iu referuar qëndrimeve të mbajtura në jurisprudencën e saj, "Gjykata Kushtetuese thekson se parimi kushtetues i fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues duhet respektuar nga të gjitha gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, mjafton që fati i çështjes të mos jetë vendosur ende përfundimisht prej tyre. Pra, sigurisht që ky parim duhet të respektohet edhe në gjykimin që mund të zhvillohet në Gjykatën e Lartë, sepse është pikërisht kjo Gjykatë që kontrollon mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta.¹

Kërkuesi Din Gjonaj pretendon se është Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë që ka zbatuar ndaj tij dispozitën penale, që parashikonte masën më të rëndë të dënimit. Ai është dënuar me 9 vjet burgim, ndërkohë që dispozita ligjore që vepronte në kohën e gjykimin të çështjes ka ndryshuar, duke parashikuar në paragrafin e dytë një dënim më të ulët.

Përsa më sipër, Gjykata Kushtetuese çmon se pretendimi i kërkuesit Din Gjonaj është i drejtë. Sipas dispozitës ligjore të kohës së kryerjes së veprës penale (neni 333 i Kodit Penal), pjesëmarrja në bandë të armatosur apo organizatë kriminale dënohet nga pesë deri në pesëmbëshjetë vjet. Kësaj dispozite ligjore i janë referuar me të drejtë gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit në aplikimin e masës së dënimit ndaj kërkuesit. Ndërkohë që çështja ndodhet për shqyrtim në Gjykatën e Lartë, me ligjin nr.9275, datë 16.9.2004, neni 333 i Kodit Penal ka ndryshuar, duke parashikuar në paragrafin e dytë, për pjesëmarrjen në organizatë kriminale, një dënim më të ulët, nga 4 deri në 8 vjet.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë duhet ta kishte marrë në konsideratë zbatimin e parimit kushtetues të fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka pranuar në vendimin e tij se pjesëmarrja e kërkuesit Din Gjonaj "*në organizatën kriminale nuk është shoqëruar me veprimtari konkrete por ka mbetur në fazën e pjesëmarrjes siç parashikon edhe neni 332/2 i Kodit Penal.*"

Megjithëse është e njohur se fuqia prapavepruese e ligjit penal favorizues përbën një nga parimet themelore të procesit gjyqësor të garantuar shprehimisht në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë e ka mënjeluar respektimin e këtij standardi kushtetues.

3. Pretendimi për shkeljen e parimit të gjykimin nga një "*gjykatë e caktuar me ligj*"

Fraza "*gjykatë ... e caktuar me ligj*" në nenin 42/2 të Kushtetutës mbulon jo vetëm bazën ligjore për vetë ekzistencën e gjykatës, por edhe kompozimin e trupit gjykues të ngarkuar për shqyrtimin e çdo çështjeje konkrete. Për pasojë, është e nevojshme të ekzaminohen pretendime të tilla si ato të rastit në shqyrtim, lidhur me shkeljen e rregullave ligjore për caktimin e gjyqtarëve në përbërje të një trupi gjykues dhe konkretisht, të nenit 28/4 të ligjit nr.8436, datë 28.12.1998 "*Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë*".

Kërkuesit kanë pretenduar se në caktimin e gjyqtarëve për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Tiranë, në rastin në shqyrtim, Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka vepruar në kundërshtim me dispozitën e mësipërme. Sipas kërkuesve, nuk rezulton se gjyqtarët e caktuar kanë dhënë dorëheqjen për shqyrtimin e çështjes në ngarkim të tyre dhe për pasojë, nuk është e vërtetë se në Gjykatën e Apelit Tiranë nuk mund të formohej trupi gjykues për gjykimin e kësaj çështjeje.

Ky pretendim i kërkuesve është i pabazuar. Sipas nenit 28/4 të ligjit të mësipërm, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, mund të emërojë një gjyqtar të gjykojë një numër çështjesh në një gjykatë tjetër të të njëjtit nivel, nëse mungojnë gjyqtarët në këtë gjykatë. Në rastin në shqyrtim, siç rezulton edhe nga materialet e dosjes, në kundërshtim me sa pretendojnë kërkuesit, disa nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë kanë dhënë dorëheqjen, e cila është pranuar nga kryetari i kësaj gjykate në bazë të rregullave të Kodit të Procedurës Penale. Për pasojë, ka qenë pikërisht rasti që parashikon dispozita e mësipërme e ligjit "*Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor ...*" kur Këshilli i Lartë i Drejtësisë cakton gjyqtarë për të gjykuar për llogari të një gjykate tjetër. Përsa sipër, Gjykata Kushtetuese konkludon se nuk ka shkelje të parimit të gjykimin nga

¹ Vendimi nr.35, datë 20.12.2005 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

një gjykatë e caktuar me ligj, parashikuar nga neni 42/2 i Kushtetutës.

4. Pretendimi për shkeljen e parimit të mosdeklarimit fajtor dhe të mosdënimit mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme

Lidhur me këtë pretendim, Gjykata Kushtetuese çmon se pranimi dhe çmuarja e provave është çështje që u takon gjykatave të zakonshme. Detyra e Gjykatës Kushtetuese është të vlerësojë nëse procesi i realizuar në këto gjykata, i shqyrtuar si i tërë, duke përfshirë edhe mënyrën e marrjes së provave, ka qenë i drejtë. Të gjitha provat duhet të paraqiten në prani të të akuzuarit, në një seancë publike, me qëllim që të realizohet një proces kontradiktor. Megjithatë, përdorimi si prova i thënieve të marra në fazën e hetimit paraprak, si dhe në kushtet që parashikon neni 369/3 i Kodit të Procedurës Penale, nuk është në vetvete i papajtueshëm me paragrafët 3(d) dhe 1 të nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (ose nenet 31/d dhe 42 të Kushtetutës), përderisa respektohet e drejta e mbrojtjes.

Si aspekte të shkeljes së nenit 32/2 të Kushtetutës kërkuesit kanë parashtruar se dëshmia e së quajturës L.Çestari është marrë në shkelje të nenit 31/d të Kushtetutës dhe nenit 6/1/3 (d) të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Në këtë kuadër, kërkuesit kanë pretenduar se janë shkelur rregullat procedurale dhe në caktimin e përkthyesit që ka asistuar në procesin e pyetjes së dëshmitares në ekzekutim të letërporosisë, si dhe në zhvillimin e njohjes me fotografi nga ana e dëshmitares L.Çestari.

Lidhur me pyetjen, me cilësinë e dëshmitares së shtetasit italiane, nga materialet e dosjes rezulton se është vepruar në përputhje me kuadrin procedural përkatës. Kështu, Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, mbi kërkesën e prokurorit të çështjes, në bazë të neneve 509 e vijues të Kodit të Procedurës Penale, si dhe të Konventës së Këshillit të Europës “Për ndihmën e ndërsjellë juridike në fushën penale” të datës 20 prill 1957 dhe të Protokollit shtesë të datës 17 mars 1997, të ratifikuar me ligjin nr.8498, datë 10.06.1999, u është drejtuar autoriteteve italiane, me qëllim që të bënin të mundur paraqitjen e së sipërpërmendurës përpara gjykatës për të dëshmuar në procesin në ngarkim të kërkuesve. Meqenëse dëshmitarja është deklaruar se nuk mund të paraqitej përpara Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë për të dëshmuar, kjo gjykatë u është drejtuar përsëri autoriteteve përkatëse që të bënin të mundur pyetjen në vendbanimin e saj në Itali.

Në këtë mënyrë, në përputhje me Konventën e sipërpërmendur si dhe në bazë të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale Italiane, pyetja e dëshmitares është realizuar nga ana e Gjykatës së Apelit, Romë. Në procesin e pyetjes kanë marrë pjesë edhe avokatët e caktuar nga gjykata kryesisht, (pasi avokatët e zgjedhur nga kërkuesit nuk kanë pranuar) prokurorët e çështjes, si dhe tre anëtarët e trupit gjykues të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Procesverbali dhe materiali i incizuar në ekzekutim të letërporosisë i është dërguar, nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë, gjykatës së shkallë së parë dhe më pas është administruar nga ana e saj në seancë gjyqësore në prani të kërkuesve. Edhe për caktimin e përkthyesit, si dhe për zhvillimin e njohjes me fotografi nuk ka shkelje. Në këtë rast, siç rezulton nga materialet e dosjes, veçanërisht nga procesverbali përkatës, organet e procedimit kanë respektuar rregullat procedurale. Në këto kushte, në kundërshtim nga sa pretendojnë kërkuesit, pyetja e dëshmitares L.Çestari është bërë në përputhje me nenin 31/d të Kushtetutës, si dhe me nenin 6/3 (d) të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Si aspekt tjetër të shkeljes së nenit 32/2 të Kushtetutës kërkuesit kanë parashtruar cilësimin si dëshmi të thënieve të shtetasit kolumbian Triana Mateus. Lidhur me këtë pretendim, nga materialet e çështjes rezulton se nga Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, me anën e letërporosisë drejtuar autoriteteve gjyqësore italiane, u është kërkuar të bënin të mundur dërgimin e disa materialeve që lidheshin me dëshminë e këtij dëshmitari. Autoritetet gjyqësor italiane, bazuar në Traktatin “Për asistencë reciproke në fushën penale” midis Republikës Italiane dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, i kanë dërguar SHBA-së letërporosinë për pyetjen me cilësinë e dëshmitarit të shtetasit kolumbian Triana Mateus, që gjendej i arrestuar pranë Zyrave Federale të Shtetit New York. Në ekzekutim të letërporosisë të sipërpërmendura, autoritetet italiane i kanë dërguar Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë materialet që pasqyronin dëshminë e tij, marrë në pyetje nga autoriteti procedues përkatës i Nju Jorkut. Siç rezulton nga vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, këto materiale janë administruar në kuadrin e leximeve të lejueshme, si “*deklarime të bëra nga shtetasi i huaj jashtë shtetit*”, në bazë të nenit 369/3 të Kodit të Procedurës Penale. Ky material është vlerësuar nga gjykata duke u lidhur edhe me provat e tjera. Përsa më sipër, Gjykata Kushtetuese nuk konstaton shkelje të aspektit kushtetues.

Në rastin në shqyrtim, megjithëse gjykatat nuk kanë qenë në gjendje të realizonin pyetjen

personalisht të dëshmitarëve të sipërcituar, kjo nuk do të thotë se ato i kanë bazuar vendimet e tyre, vetëm, apo në një masë të madhe, në dëshmitë e marra nëpërmjet letërporosive. Ato janë bazuar edhe në dëshmitë e tjera, të marra në seancë gjyqësore dhe të dëshmitarëve të pyetur në fazën e hetimit gjyqësor, dhe në një sërë dokumentesh e provash materiale.

Prandaj, Gjykata Kushtetuese çmon se edhe ndonjë kufizim, që mund të jetë imponuar mbi të drejtat e mbrojtjes, nuk ka qenë i tillë sa të privojnë kërkuesit nga e drejta për zhvillimin e një gjykimi të drejtë. Për pasojë, Gjykata Kushtetuese konkludon se nuk ka pasur shkelje të nenit 6/1/3 (d) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe të neneve 31/d dhe 32/2 në lidhje me nenin 42 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë.

Edhe pretendimi se aktet e dosjes nr.1010/99 të ardhura nga Italia, nuk mund të konsiderohen si prova të vlefshme, nuk është i bazuar. Nga materialet e dosjes rezulton se dosja e mësipërme, në ekzekutim të letërporosive të sipërpërmendura, është dërguar nga ana e autoriteteve italiane, në rrugë institucionale, duke respektuar të gjithë procedurën përkatëse që parashikon Kodi i Procedurës Penale, si dhe konventa përkatëse e Këshillit të Europës.

Pretendimi për shkeljen e së drejtës së mbrojtjes me avokat, parashikuar nga neni 31/ç në lidhje me nenin 42 të Kushtetutës, si dhe neni 6/1/3c i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, është i pabazuar. Nga materialet e dosjes rezulton se kërkuesit janë mbrojtur nga avokatë të zgjedhur nga vetë ata. Për shkeljen e kësaj të drejte kërkuesit i referohen seancës gjyqësore të datës 18.3.2003 të zhvilluar nga Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë. Në këtë seancë, gjykata e ka përjashtuar avokatin e kërkuesit Sokol Koçi, për shkelje të rregullave të seancës gjyqësore, dhe në vend të tij ka caktuar kryesisht një avokat tjetër. Me caktimin e këtij avokati, seanca në këtë datë është ndërprerë. Në këto rrethana, Gjykata Kushtetuese çmon se caktimi i një avokati kryesisht për kërkuesin, në vend të avokatit të zgjedhur prej tij, nuk ka cenuar të drejtën e mbrojtjes së kërkuesit.

Lidhur me pretendimet e tjera që kanë parashtruar kërkuesit, të cilat kanë marrë përgjigje të arsyetuar nga vendimi i Kolegjit Penal i Gjykatës së Lartë, Gjykata Kushtetuese çmon se nuk janë të natyrës kushtetuese dhe për rrjedhojë, duhen rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131 shkronja “f”, 134 pika 1 shkronja “g” të Kushtetutës, si dhe në nenet 72 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës së paraqitur nga kërkuesi Din Gjonaj dhe rrëzimin e saj për kërkuesit e tjerë.

- Shfuqizimin pjesërisht si antikushtetues të vendimit nr.295, datë 12.5.2006 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, në pikën 4 të tij, që lidhet me kërkuesin Din Gjonaj.

- Dërgimin e çështjes për shqyrtim Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM

Nr.15, datë 18.4.2007

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergji Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “

Vjollca Meçaj	Anëtare e	“	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar i“	“	
Petrit Plloçi	Anëtar i“	“	
Sokol Sadushi	Anëtar i	“	“
Alfred Karamuço	Anëtar i“	“	

me sekretare Brunilda Bara, në datë 20.2.2007, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.25 Akti, që i përket:

KËRKUES: SHPËTIM DAMA, përfaqësuar nga avokatët Maksim Haxhia e Artan Hajdari, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR: KËSHILLI I RREGULLIMIT TË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar me Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, Artan Kodheli, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimeve nr.13, datë 7.5.2003 të KRRTRSH-së; nr.5422, datë 19.12.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr.38, datë 28.6.2005 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.890, datë 30.6.2006 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Kërkuesi, për antikushtetutshmërinë e vendimeve të sipërcituara, ka ngritur si shkaqe:

- KRRTRSH, me vendimin e atakuar ka vendosur shpronësimin *de facto* të pronës së tij, pa pasur në kompetencë një veprim të tillë.

- Gjykatat, në të gjitha fazat e gjykimit ku është ngritur pretendimi i mësipërm, e kanë anashkaluar atë pa e analizuar e dhënë përgjigje.

Avokati i Përgjithshëm i Shtetit ka parashtruar:

- Kërkuesi nuk mund të pretendojë për cenim të pronësisë sepse ai nuk është pronar. Truallin dhe objektin mbi të i ka përfituar me veprime fiktive të pavlefshme.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Alfred Karamuço, përfaqësuesin e kërkuesit, përfaqësuesin e subjektit të interesuar dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Kërkuesi Shpëtim Dama, mbi bazën e vërtetimit të lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Pasurisë, figuronte si pronar i një trualli të blerë nga Bashkia Tiranë në vitin 2000 dhe objektit të ndërtuar mbi të (bar-restorant) në sheshin “Italia”. Me iniciativën e tij dhe të Bashkisë së Tiranës, u vendos që në truallin ekzistues, pas prishjes së objektit, të ndërtohej një objekt trekatësh, sipas vendimit nr.31, datë 24.5.2002 të KRT-së së Bashkisë Tiranë. Mbi bazën e këtij vendimi, u plotësuan dhe u miratuan të gjitha dokumentet e nevojshme. Meqenëse ndërtimi bëhej në zonë të mbrojtur, me kërkesën e bashkisë, Instituti i Monumenteve të Kulturës, me shkresën nr.915, datë 18.2.2003, ka pranuar ndërtimin duke u shprehur se objekti “... është në zonën e mbrojtur, respekton distancat nga monumentet përreth tij, si dhe kriteret e ndërhyrjes në zona të tilla”.

Kërkuesi ka lidhur marrëveshje me subjektin ndërtues “Pegaso” dhe ka filluar puna me prishjen e objektit ekzistues, autorizuar nga KRRT-ja e Rrethit të Tiranës me vendimin nr.13, datë 13.6.2002.

Në kohën kur bëheshin punimet përgatitore të objektit të miratuar, KRRTRSH-ja, merr vendimin nr.13, datë 7.5.2003, sipas të cilit:

“1. Shfuqizohet vendimi i KRRT-së së Bashkisë Tiranë nr.31, datë 24.5.2002 për miratimin e sheshit të ndërtimit të objektit “Kompleks rekreativ trekatësh + bodrum në Sheshin “Italia” në pronë të zotit Shpëtim Dama, dhe vendimi nr.38, datë 13.6.2002 i KRRT-së së Bashkisë Tiranë për miratimin e lejes së ndërtimit të këtij objekti, në favor të subjektit ndërtues “Pegaso”.

2. Të kthehet në gjendjen e mëparshme si lulishte, përcaktuar në planin rregullues, territori i mësipërm, si pjesë përbërëse e ansamblit monumental të sheshit “Italia”.

Kërkuesi e ka kundërshtuar këtë vendim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke parashtruar se ai është marrë në kundërshtim me kërkesat e ligjit. Veçanërisht në kërkesëpadi ngrihet

se me vendimin objekt kundërshtimi KRRTRSH-ja ka bërë shpronësimin e kërkuarit pa u respektuar kërkesat kushtetuese e ligjore përse i përket shpronësimit. Gjatë gjykimit në gjykatën e rrethit gjyqësor e atë të apelit, ndër shkaqet kryesore për shfuqizimin e aktit, kërkuari ka argumentuar se KRRTRSH-ja nuk është organi kompetent për kryerjen e shpronësimit. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.5422, datë 19.12.2003, ka rrëzuar padinë, duke u ndaluar në arsyetimin se KRRT-ja e Bashkisë së Tiranës nuk ka pasur të drejtë të miratonte ndërtim në zonën e përcaktuar të gjelbër, jashtë funksioneve të territorit dhe se territori në konflikt është i përfshirë në zonën e Ansamblit Monument Kulture, shpallur me vendim të Këshillit të Ministrave. Përse i përket pretendimit lidhur me cenimin e paligjshëm të së drejtës së pronës, Gjykata nuk e ka vënë në bisedim dhe as që është shprehur në vendimin e saj. Edhe Gjykata e Apelit Tiranë në vendimin nr.773, datë 28.6.2005 e ka anashkaluar pretendimin për shpronësim si një shkak thelbësor i padisë, i parashtruar edhe në kërkesën ankimore.

Gjykata e Lartë, me arsyetimin se në rekursin e paraqitur nuk ka shkaqe ligjore, ka vendosur mospranimin për shqyrtim në seancë gjyqësore.

Gjykata Kushtetuese arrin në përfundim se vendimet gjyqësore të përmendura më lart janë rrjedhojë e proceseve të parregullta gjyqësore, e si të tilla duhet të shfuqizohen.

Siç del nga shqyrtimi i çështjes, pretendimi i kërkuarit lidhur me paligjshmërinë e vendimit të KRRTRSH-së, veçanërisht për cenimin e pronës së tij, është një pretendim thelbësor. Ai lidhet me të drejtën kushtetuese të parashikuar nga neni 41 i Kushtetutës, për të pasur një pronë private të garantuar dhe për një shpronësim apo kufizim të saj, të bërë me ligj, nga një organ kompetent, vetëm për interesa publike dhe kundërt një shpërblimi të drejtë. Këto të drejta e garanci janë shkelur nga vendimi i atakuar i KRRTRSH-së dhe për të cilat gjykatat, edhe pse ishin të detyruara të shpreheshin, nuk i kanë shqyrtuar e as janë shprehur në vendimet e tyre.

Mënjanimi plotësisht në shqyrtimin gjyqësor e në vendim i shkakut që lidhet me shpronësimin e paligjshëm, i bën këto gjykime të njëanshme në kuptimin e procesit të parregullt ligjor.

Jurisprudenca e Gjykatatës Kushtetuese ka pranuar si detyrim kushtetues gjykimin e paanshëm nga gjykatat. Në një nga çështjet e shqyrtuara prej saj mbi këtë problem, Gjykata Kushtetuese është shprehur se: “Në vendimin e saj, gjykata e apelit nuk i jep përgjigje argumenteve të parashtruara ... nga pala e paditur, duke krijuar dyshime se ajo në zgjidhjen e kësaj çështje ka qenë e njëanshme”. Më tej vendimi shprehet se “... në këtë proces nuk është respektuar parimi i paanshësisë në gjykim, që në rastin konkret reflektohet në drejtim të pranimit në mënyrë të njëanshme të kërkesave vetëm të njërës palë, pa dhënë argumente ligjore, si dhe të mosdhënies përgjigje dhe të mosanalizimit të argumenteve që ka parashtruar pala tjetër”.¹

Ekulibri në proces, pranimi i barazisë së armëve, duke mos lejuar avantazh të konsiderueshëm të njërës palë ndaj tjetrës, janë kërkesa të cilat janë pranuar edhe nga Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut si elemente të rëndësishme që kanë të bëjnë me paanshmërinë e në analizë të fundit me procesin e rregullt ligjor. Në vendimet e saj kjo Gjykatë pranon se “Paanshmëria konsiderohet një parim i rëndësishëm, që garanton rendin e së drejtës dhe mundëson krijimin e besimit që gjykatat duhet të gëzojnë në një shoqëri demokratike”.²

Duke konkluduar për antikushtetutshmërinë e vendimeve gjyqësore, Gjykata Kushtetuese i jep përgjigje edhe kërimit të bërë nga kërkuari lidhur me antikushtetutshmërinë e vendimit nr.13, datë 7.5.2003 të KRRTRSH-së si akt administrativ. Në lidhje me këtë kërkim, Gjykata Kushtetuese, duke iu referuar shkronjës “f” të nenit 131 të Kushtetutës, konkludon se ajo, nuk mund të bëjë gjykimin përfundimtar të kësaj pjese të kërkesës, pa u shqyrtuar në rrugën e gjykimit të zakonshëm, gjë e cila përse u analizua në tërësi në vendim, nuk është realizuar.

Në këto kushte, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundim se vendimet nr.5422, datë 19.12.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr.38, datë 28.6.2005 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.890, datë 30.6.2006 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, nuk janë në përputhje me Kushtetutën e si të tilla duhet të shfuqizohen.

¹ Vendimi nr.20, datë 2.7.2003 i Gjykatës Kushtetuese.

² M. A. Novicki “Rreth Konventës Europiane”, fq.182-183.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës si dhe neneve 72 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimeve nr.5422, datë 19.12.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr.38, datë 28.6.2005 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.890, datë 30.6.2006 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË
2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR
3. REGJISTRAT E NOTERISË
4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:

1.	PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006).....	1500
2.	PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005)	600
3.	PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllimi i I-rë dhe vëllimi i II-të-2006).....	1300
4.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500

Botime të reja

1	TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
2	TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
3	TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
4	TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
5	PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË.....	1000
6	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR.....	800
7	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET.....	500
8	PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006).....	1000
9	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE.....	500

Hyri në shtyp më 20.4.2007
Doli nga shtypi më 23.4.2007

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja
Tiranë, 2007

Çmimi 24 lekë